

Konfliktet

Te konfliktet në partneritet apo familje ndihmojnë qendra të ndryshme këshilluese. Dhuna në familje apo bashkëshortësi është e ndaluar.

Konfliktet në marrdhënie të partnerëve

Kur te partnerët vie deri te konfliktet, munden partnerët të marrin ndihmë profesionale (Eheberatung). Këshillimoret speciale ju ndihmojnë ju, të gjeni zgjidhje. Bisedat e para janë zakonisht falas apo të liruara. Në çdo rajon ka për këtë një këshillimore përgjegjëse.

Konfliktet në familje

Në familjet me fëmijë mundet nganjëherë me ardhë në situata të vështira, të cilat për prindër e fëmijë munden me qenë të besdizshme. Është në çdo rast të propozohet, që prindërit të marrin ndihmë, kur nuk din më si t`ia bëjnë tutje. Te këshillimoret për familje (Familienberatungsstelle) mundet njeriu personalisht të këshillohet. Në thirrjen urgjente për prindër (Elternnotruf) këshillojnë njerëzit specialist në telefon apo në Mail, gjatë pyetjeve për edukim apo kur keni brenga për fëmijun tuaj (telefoni 0848 35 45 55 (falas, www.elternnotruf.ch). Fëmijët dhe të rinjët munden përmes telefonit, mail, sms apo chat në thirrjen urgjente për fëmijë (Kindernotruf) të thërrasin (telefoni 147 (kostenlos), www.147.ch).

Dhuna shtëpiake

Dhuna në familje është një delikt zyrtar. Kush ushtron dhunë, e bënë veten të dënueshëm- pavarësisht nga pesha e dhunës. Nuk ka rëndësi, a është dhuna kundrejt partnerës, partnerit në martesë apo fëmijëve e drejtuar. Zyrtarët duhet të bëhen aktiv, kur të kuptojnë për dhunën në familje. Për viktimat të dhunës ka oferta me besim mbështetëse falas. Në banime speciale (Frauenhaus / Väterhaus) munden gratë apo burrat s`bashku me fëmijët e tyre përkohësisht të kërkojnë mbrojtje. Në shtëpinë e grave munden gratë e goditura nga dhuna përgjatë gjithë kohës të telefonojnë (telefoni 061 681 66 33). Fëmijët dhe të rinjët munden në thirrje urgjente për fëmijë (Kindernotruf) të thërrasin (telefoni 147 (falas), www.147.ch). Kush ndihet i kërcënuar nga një antarë i familjes, duhet ta thërras policinë (telefoni 117). Këta munden që një person, që ushtron dhunë apo kërcënohet të ushtroj dhunë, për një kohë të gjatë ta largoj prej banesë apo shtëpie.

Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

www.hallo-baselland.ch/sq/marredhenie-partneresh-dhe-femijet/konfliktet